

VENDIM
Nr.647, datë 28.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR DHËRMI - VUNO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi - Vuno.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen kullotë 2531 m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 507 465 (pesëqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 270 000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera totale e shpronësimit prej 507 465 (pesëqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.8.2010 dhe të përfundojë më 30.10.2010.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP Vlorë (bashkëpronësi)”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP Vlorë (bashkëpronësi)”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRASPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI SEGMENTIT
RRUGOR DHËRMI-VUNO

Nr.	Pronari	Zk	Nr. regjistri hipotekor	Kullotë			Shënime
	Emri			Sip.m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	
	Guliem Petro Trola Vasilika Petro Gjini (Trola) Liri Petro Kora (Trola) Spiro Petro Trola Kristina Petro Trola Polikseni Trola Edmond Foto Trola Aleksandra Foto Trola Agron Foto Trola	3844	52	2531	200.5	507465.5	Konfirmuar nga ZRPP Vlorë Bashkëpronësi
	Totali			2531		507465.5	